

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"			
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË			
PRISHTINA			
Pranuar	29.05.19	viti	
Nj. org.	Numër	Sasia	Vlera
02	02-		



 Marrëveshje Bashkëpunimi		REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Shëndetësisë / Ministerstvo Zdravstvo / Ministry of Health Institut Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës Nacionalni Institut Javnog Zdravstva Kosova National Institute of Public Health of Kosovo	
Njësia org.	01	Nr. Prot.	710
Org. Jedin.	3	Br. Prot.	
Org. Unit.		Prot. Nr.	
Nr. i faqeve		Data	12.06.2019
Br. Stranë		Datum	
		Data	
Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë			

ndërmjet

dhe

Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës

Preamble

Duke kuptuar rëndësinë dhe vlerën e bashkëpunimit dhe shkëmbimeve në nivel kombëtar, Prof. Dr. Skender Kaçiu, Dekan i Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", dhe Prof. Dr. Naser Ramadani, Drejtor i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës - Prishtinë, janë të interesuar reciprokisht për të vazhduar marrëdhënet e tyre në zgjerimin e bashkëpunimit dhe intensifikimin e aktiviteteve hulumtuese shkencore, akademike dhe aplikative me interes për shëndetin publik ne konceptin "Një Shëndet" – "OneHealth".

Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë (FBV), Prishtinë, referuar më poshtë si "FBV", me lokacion në Prishtinë, përfaqësuar nga dekani Prof. Dr. Skender Kaçiu.

dhe

Institutit Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, në vijim referuar si "IKSHPK", me lokacion në Prishtinë, i përfaqësuar nga Prof. Dr. Naser Ramadani.

Të referuar më poshtë si "palët".

DUKE MARRË PARASYSH se FBV është institucion i arsimit të lartë dhe ka kompetencë të përgjithshme në fushat e mjekësisë veterinare, sigurinë dhe higjenën e ushqimit, shëndetin publik, mbrojtjen e bimëve dhe akuakulturën;

DUKE MARRË PARASYSH se IKSHPK është institucioni më i lartë shëndetësor, profesional dhe shkencor i Kosovës, i cili organizon, zhvillon, mbikëqyrë dhe zbaton politikat e shëndetësisë

publike në Kosovë. Instituti zhvillon punën hulumtuese-shkencore dhe mbulon aktivitetet e ruajtjes dhe mbrojtjes së shëndetit publik në Kosovë.

Të dy institucionet bien dakord për të nxitur dhe mbështetur reciprokisht marrëdhënie bashkëpunuese, me theks në zhvillimin dhe intensifikimin e projekteve hulumtuese dhe shkencore, shkëmbimet e stafit dhe informacioneve me interes, realizimin dhe bashkërendimin e aktivitetave kërkimore dhe aplikative në konceptin “Një Shëndet”, si dhe ofrimit të përdorimit të infrastrukturës teknike dhe laboratorike.

Aktivitetet bashkëpunuese

Palët bien dakord për veprimtaritë e mëposhtme të bashkëpunimit:

Kontributi i Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë

1. FBV është e gatshme të kontribuojë në punët shkencore dhe profesionale që kanë të bëjnë me aktivitetet e shëndetit publik veterinar, sigurisë së ushqimit dhe mbrojtjes së ambientit.
2. FBV do të informojë sipas nevojës IKSHPK me hulumtimet shkencore të realizuara në fushën e mjekësisë publike veterinare dhe sigurisë së ushqimit në Kosovë dhe me gjërë.
3. FBV në bazë të informacioneve shkencore dhe profesionale mund të rekomandoje IKSHPK përmarrjen e masave të reja në funksion të mbrojtjes dhe ruajtjes të shëndetit publik në Kosovë.
4. FBV do të ofrojë resurse humane dhe infrastrukturën e nevojshme teknike dhe laboratorike në funksion të kryerjes së punëve shkencore dhe laboratorike që realizohen në IKSHPK dhe FBV.

Kontributi i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës

1. Duke u mbështetur në dispozitat ligjore të nenit 10 të Statutit të IKSHPK-së, do të bashkëpunoj dhe do të ofrojë infrastrukturën e nevojshme teknike dhe laboratorike përkryerjen e punëve shkencore dhe profesionale në funksion të ruajtjes së shëndetit publik dhe mbrojtjes së konsumatorit.
2. IKSHPK është e gatshme të ofrojë bashkëpunim profesional dhe shkencor dhe të marrë pjesë në projekte të përbashkëta kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e kontrollit dhe parandalimit te sëmundjeve zoonotike, sigurisë ushqimore, ujit të pijshëm, mbrojtjes së ambientit dhe sëmundjeve të përhapura nga vektorët, me konceptin “Një Shëndet”.
3. IKSHPK do të bashkëpunojë me FBV për hartimin e strategjive të përbashkëta për parandalimin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve zoonotike dhe monitorimin e përbashkët të tyre.
4. IKSHPK do të bashkëpunojë me FBV për nxjerrjen e një materiali informativ lidhur me masat që merren në funksion të ruajtjes dhe mbrojtjes së shëndetit publik dhe shkëmbimin e informacioneve me interes.

Fushat e bashkëpunimit

Fushat e bashkëpunimit do të përfshijë çdo program të ofruar i cili është vlerësuar nga palët që të jetë e dëshirueshme dhe e mundshme për zhvillimin dhe forcimin e marrëdhënieve bashkëpunuese ndërmjet dy institucioneve me interes nacional dhe me gjërë.

Procedurat e implementimit

Zbatimi i aktiviteteve të cilat janë të përcaktuara në detajet dhe procedurat e aktiviteteve të bashkëpunimit sipas kësaj Marrëveshje, do të përfundohet dhe rregullohet nga program i posaçëm pune ndërmjet Palëve.

Financimi i shkëmbimeve

Institucionet në këtë marrëveshje do të bëjnë përpjekje për të siguruar fonde për aktivitete bashkë punuese nga burime të brendshme dhe të jashtme në dispozicion të tyre, duke përfshirë fondet e donatoreve apo nëpërmjet programeve tjera. FBV pajtohet të sigurojë materialet harxhuese laboratorike sipas kërkesës së arsyeshme të dy palëve.

Konfidencialiteti

Institucioni duhet të respekton konfidencialitetin e informatave dhe nuk guxon t'ia përhap askujt përpos nëse bartja e informatave është e obligueshme nga ana e një institucioni kompetent.

Vlefshmëria, rinovimi, ndryshimet dhe përfundimi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga të dyja palët dhe vlen përnjë periudhë të pacaktuar. Ndryshimet mund të inkorporohen me marrëveshje të dyanshme në formë të shkruar. Përfaqësues i secilës Palë mund ta përfundojë këtë Marrëveshje me anë të një njoftimi me shkrim të paktën gjashtë muaj para datës së skadimit të saj. Përfundimi i tillë nuk do të ndikojë në aktivitetet tashmë të filluara në kuadër të kësaj marrëveshjeje para marrjes së këtij njoftimi.

Palët, me nënshkrimin nga përfaqësuesit e tyre të autorizuar më poshtë, e pranojnë se kanë lexuar dhe kuptuar Marrëveshjen dhe pajtohen të pranojnë dhe tu përbahen termave dhe kushteve të saj.

**Nënshkruar për Fakultetin të Bujqësisë
dhe Veterinarisë - Prishtinë**



Dekani
Prof. Dr. Skender Kaçiu

Datë: 28.05.2019

**Nënshkruar për Institutin Kombëtar të
Shëndetësisë Publike të Kosovës -
Prishtinë**



Drejtori
Prof. Dr. Asoc. Naser Ramadani

Datë: 28/05/2019